



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e –VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
13 korrik 2018 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Melihate Basholli-Latifi, Nezir Klinaku dhe Lutfi Bilalli (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Berat Sadiku, Berat Asllani), si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se desha të flas lidhur me rendin e ditës, mirëpo pasi që nuk është kryetari i komunës i pranishëm nuk dua të flas. Ai tha se është bërë shumë zhurmë lidhur me heqjen nga rendi i ditës në mbledhjen e kuvendit: Propozim-vendimi për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri. Propozimi im atë ditë ka qenë që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe të ulen partitë politike të bisedojmë paraprakisht dhe ta gjejmë një konsensus, sepse nëse jemi opozitë nuk jemi armiq. Prandaj, unë nuk kam qenë që të jetë prapë kjo pikë e rendit të ditës pa një marrëveshje të subjekteve politike.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.6.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Raportit janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës janar-qershor 2018;
6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018;
7. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë ushqimore;

8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018;
9. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.6.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës kjo pikë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Raportit janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se kryetari nuk po e sqaron se cilat shpenzime po i publikon në web faqe dhe në “facebook”.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se çdo shpenzim që e bëj e publikoj edhe në web faqe.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – e pyeti se shpenzimet e telefonit a i publikon?

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – përsëri deklaroi se çdo shpenzim që e bëj e publikoj. Tahiri tha se shpenzimet që mbesin pa u publikuar në javë, në formë përmbledhëse i publikoj në fund të muajit. Qëllimi im është që të krijoj një praktikë të mirë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se nuk pajtohet me këtë, prandaj tha se po kërkon transparencë.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – tha se tek mirëmbajtja e shkollave kemi një diferencë (shpenzime më pak) në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi se arsyeja e kësaj është se për shkak se disa projekte të shkollave ende janë në procedurë të prokurimit.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – pyeti lidhur me shpenzimet e vendimeve të gjykatave, që siç tha ai janë shpenzime të mëdha.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – sqaroi se këto shpenzime janë për shkak të pagesave që komuna është dashur t'i paguajë, pasi që punëtorët e arsimit kanë paditur komunën për shkak të mospagesës të tri pagave pas pensionimit të mësimitdhënësve dhe mospagesën e tri pagave pas punës 10 vjeçare në arsim. Sipas Tahirit, kjo është një praktikë e mbrapshtë që është krijuar nga organet qendrore, duke shtuar se këtë çështje e kam ngritur edhe në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – kërkoi që të specifikohen emrat e rrugëve që janë në procedurë për asfaltim. Kjo për shkak se duhet të dihet cila rrugë, në cilin fshat është në procedurë të prokurimit, e jo vetëm të thuhet në mënyrë të përgjithshme psh. “asfaltimi i rrugëve në filan fshatin”. Tutje tha se edhe në të kaluarën është vepruar kështu, prandaj po kërkoj që të ndryshohet kjo mënyrë.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – kërkoi që prioritetet për realizimin e projekteve të bëhen në bashkëpunim me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane, për arsye se është një praktikë më funksionale.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që të futet në draft-buxhet ndërtimi i kanalizimit në fshatin Stroc, pasi që kjo ka qenë kërkesë e banorëve në takimin për dëgjimet buxhetore.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – theksoi se emërtimet e shesheve në të kaluarën janë bërë “shkel e shko”. Ja shikoni se me çfarë standardi është emërtuar sheshi “Azem dhe Shotë Galica” (prezantoi dokumentacionin), po ashtu edhe sheshi “Hasan Prishtina”. Emërtimi i tij është bërë në kuadër të emërtimit të listës së rrugëve, e jo me një propozim-vendim të veçantë, tha ai. Pastaj deklaroi se propozim-vendimi për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri është i kompletuar, madje edhe me pamje 3D.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – tha se në mbledhjen e kaluar të KPF-së, të gjithë që ishim prezent (përveç Nezirit, i cili ka abstenuar) kemi votuar që ta procedojmë në kuvend, kurse në mbledhjen e kuvendit u krijua një situatë krejt tjetër.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – sqaroi se ka kërkuar që të hiqet nga rendi i ditës në mbledhjen e kaluar të kuvendit. Propozimi im atë ditë ka qenë që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe të ulen partitë politike të bisedojmë se a është vendi adekuat për emërtimin e sheshit dhe paraprakisht dhe ta gjejmë një konsensus. Kjo nuk ka ndodhur, pra si parti politike nuk jemi ftuar paraprakisht për të diskutuar lidhur me këtë çështje. Prandaj, ju numrat i keni, përdoreni “arrogancën e numrave”.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se atë ditë në kuvend ne kemi kërkuar informacione shtesë për këtë çështje, prandaj kemi votuar që të shtyhet. Ne si VV e mbështesim këtë propozim-vendim.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se edhe në të kaluarën ka ekzistuar “arroganca e numrave”, por kjo aktuale nuk ka të përbashkët me të kaluarën. Ai tha se ky shesh është dashur më herët të emërtohet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se emërtimi i këtij sheshi është dashur të bëhet më vonë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” dhe një (1) votë “abstenim” (Nezir Klinaku), e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës janar-qershor 2018.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se testi i arritshmërisë qenka më keq se vitin e kaluar. Ai pyeti se cila është arsyeja e kësaj rënie?

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – theksoi se vlerësimin e testit të arritshmërisë dhe administrimin e të dhënave e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – pyeti se a dihet se në cilat lëndë ka rënie? Kjo për shkak se në të ardhmen të përmirësohet gjendja.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – deklaroi se në fund të vitit kur bëhet raporti përmbledhës mund t'i kemi këto të dhëna.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – kërkoi që të bëhet depolitizimi i arsimit. Haradinaj kërkoi nga Drejtoria për Arsim që ta gjejnë zgjidhjen për një nxënës të shkollës fillore “Liria” në Stroc (djali i Xhavit Saraçit), i cili është operuar nga një operacion i rëndë. Familja e tij kërkojnë një ulëse speciale për transportin e këtij nxënësi deri në shkollë, dhe sipas informacioneve që kam, komuna e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – sqaroi se prindi i këtij nxënësi së bashku me drejtorin e shkollës dhe shoferin që i transporton nxënësit kanë qenë tek unë në zyrë dhe kemi biseduar për çështjen e ulëses. Drejtoria për Arsim nuk e ka refuzuar, por ata janë dakorduar që këtë çështje ta zgjidhin vet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë ushqimore.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – kërkoi që për kuvend të përmirësohet një gabim teknik në faqen e parë, që në vend të janar-mars 2018 të jetë janar-qershor 2018.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës kjo pikë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – paraqiti shqetësimin e tij lidhur me veprat penale kundër narkotikëve. Ai tha se institucionet kompetente duhet të ndërmarrin masa pasi sipas këtij raporti kemi raste të larta të përdorimit të narkotikëve. Ai kërkoi që në mbledhjen e kuvendit të na ofrohet një tabelë krahasuese dhe të bëhen krahasime se si ka qenë gjendja e narkotikëve në këtë vit dhe në vitet e kaluara në Vushtrri.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së deklaroi se në kuvend duhet të jemi aktiv rreth kësaj çështjeje dhe në prezencë të komandantit të policisë t'i adresojmë këto probleme. Ai kërkoi që përveç komandantit të policisë, të ftohet për kuvend edhe ndonjë zyrtar që merret me çështjen e narkotikëve.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – theksoi se inspektorët e kanë rrit intensitetin e inspektimeve sa i përket kësaj çështjeje, sepse kemi pranuar edhe ankesa nga qytetarët lidhur me përdorimin e narkotikëve në qytetin e Vushtrrisë.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – ngriti si shqetësim zhurmën gjatë natës, e cila si një dukuri është mjaft shqetësuese. Ai tha se përveç zhurmës në restorante, shqetësuese është bërë edhe zhurma nëpër shtëpitë private, ku lëshohet muzika deri në orët e vona të mesnatës pa ndonjë kontroll.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – u shpreh se edhe policia e Kosovës, por edhe inspektorati kanë bërë inspektime sa i përket çështjes së zhurmës. Në këtë rast, inspektorët tanë kanë lëshuar mbi dhjetë (10) urdhëresa lidhur me mosrespektimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma, kurse kemi dy (2) raste që i kemi dërguar në gjykatë lidhur me mosrespektimin e orarit të punës.

Mbledhja përfundoi në orën **15:30**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



N Aliu **Nasuf Aliu**

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së